



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 23/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.01.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-43724-11-18-2019, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të godinave dhe ambienteve rrethuese të Spitalit Rajonal Dibër”- Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, tre vend roje me tre turne (T1+T2+T3)”, me fond limit 9.487.854 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 20.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.

**Ankimues:** “International Security Albania” shpk  
Blv. “Zogu I”, Pallati nr. 55/1, Shkalla nr. 1, Kati 2-të, Ap nr. 9,  
Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor** Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër  
Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

*publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes.*

II.1. Në datën 19.11.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-43724-11-18-2019, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të godinave dhe ambienteve rrethuese të Spitalit Rajonal Diber"- Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, tre vend roje me tre turne (T1+T2+T3)”, me fond limit 9.487.854 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 20.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.

II.2. Në datën 25.11.2019, operatori ekonomik “International Security Albania” sh.pk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, duke kundërshtuar kërkesat e dokumentave të tenderit, si më poshtë vijon:

*“International Security Albania ” shpk u njoh me proceduren e publikuar ne sistemin e prokurimit publik per “Objekti i kontrates/marreveshjes kuader”Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private te godinave dhe ambienteve rrethuese te Spitalit Rajonal Diber”, Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj, tre vend roje me tre tume (T1+T2+T3)”, publikuar ne sistemin e prokurimit publik me date 19.11.2019 nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria Spitalit Rajonal Diber.*

*Ne lidhje me proceduren e sipercituar disa nga kriteret e publikuara jane ne kundërshtim me ligjin Nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" si dhe ne kundërshtim me ligjin 75/2014 per "Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" udhezimi nr 130 date 05.03.2018, konkretisht kriteret qe kundërshtojme jane si me poshte:*

*Se pari: Tek kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 12, ju kerkoni:*

*Salle operative ne pronesi ose me qera me vendndodhje ne qytetin e Peshkopise. Autoriteti Kontraktor ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi perkatesisht Ligjin 75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", kerkon Akt Miratim te miratuar nga DVP Diber me seli Bashkia Peshkopi. Sqarojme A.K se Bashkia Peshkopi eshte nen juridiksionin e DVP Diber dhe kur nje operator Qendren e Kontrollit e ka ne ne nje zone administrative te Qarkut Diber, akti i miratimit eshte i vlefshem per te gjithe qarkun Diber njekoheisht edhe per qytetin Peshkopi i cili ben pjese ne qarkun e Dibres dhe DVP Dibres eshte ajo qe ka juridiksionin e ketij qarku. Te kerkosh qender kontrolli ne rastin konkret ne njesine administrative Peshkopi nuk eshte ne gjykimin tone kriter ligjor por eshte thjesht nje tentative per te kufizuar pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne kete procedure kjo se paku eshte mese evidente. Sic eshte dhe evidente kerkesat absurde te certifikatave te pronesise apo kontratave te qirase, perderisa DVP Diber si organi certifikues i salles se kontrollit pajis Operatorin me Akt-Miratimin e salles se kontrollit, dokumentacioni tjeter qe ju kerkoni eshte i panevojshem.*

*Per sa me lart i kerkojme A.K te ndryshoje kriterin e sipercituar duke hequr shprehjen me vendodhje ne qytetin Peshkopi por duke e lene qe salla operative te jete Brenda QARKU Diber.*

*Se dyti: tek specifikimet teknike nuk keni saktësuar se me sa roje duhet te kryhet sherbimi ne vendrojet perkatese.*

*Duhet te specifikoni sakte numrin e rojeve per nje vendroje me sherbim 24-ore qe te mos krijohet konfuzion ne pergatitjen e oferte ekonomike.*

*Se treti: Tek kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 7 ju kerkoni : Operatori Ekonomik duhet te paraqese Vertetim Performance nga Drejtorite Vendore te Policise ku ndodhen objektet ku do te kryhet sherbimi, leshuar brenda 3 (tre) muajve, nga data e hapjes se ofertave, ku te jepet informacioni si me poshte:*

- a. Per numrin e armeve te krahut dhe armeve te brezit ne pronesi.*
- b. te grupeve te gatshme punonjesh per verifikim te sinjaleve te alarmit*
- c. qe ka radiokomunikimi, hekura lidhes, shkopinj gome.*

*Nuk ka mase administrative per Operatorin Ekonomik (Subjektin) gjate periudhes 1 Janar 2019 e ne vazhdim.*

*Te kerkesa ne germen "a" sakteson numrin e armeve qe kerkohet ?*

*Te kerkesa ne germen "b" sakteson numerin e grupe te gatshme punonjesh per verifikim te sinjaleve te alarmit qe kerkohet ?*

*Te kerkesa ne germen "c" sakteson numerin e radiokomunikimi, hekura lidhes, shkopinj gome qe kerkohen?*

*Duhet te specifikoni sakte numerin e armeve, te grupit te gatshem si dhe numrin e mjeteve speciale qe kerkohen qe te mos krijohet konfuzion ne pergatitjen e ofertes ekonomike.*

*Per sa me siper kerkojme nga Ju si Autoritet Kontraktor :*

- 1- Pezullimin e Procedures.*
- 2- Shqyrtimin dhe marrjen parasysh te ankeses tone.*
- 3- Publikimin e ndryshimeve ne DST ne sistemin e prokurimit elektronik.*
- 4- Njoftimin e O.E. "International Security Albania" shpk brenda afateve ligjore sic e parashikon neni 63, pika 5 e ligjit Nr.9643, date 20.11.2000 "Per Prokurimin Publik".*

II.3. Nëpërmjet shkresës nr. prot. 1190/3, datë 02.12.2019 autoritetit kontraktor i kthen përgjigje operatorit ekonomik “International Security Albania” shpk, ku ka vendosur pranim pjesërisht të ankesës dhe konkretisht ka kthyer përgjigje mbi pretendimin e dytë të ankimuesit (duke saktësuar se numri i rojeve për një vëndroje me tre turne është 4,98 roje) si dhe ka pranuar pretendimin e tretë (duke hequr pikën që i referohet të dhënave mbi disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në vëtetimin e performancës), duke publikuar gjithashtu dhe modifikimet e mësipërme në shtojcën nr.1, datë 02.12.2019.

II.4. Në datën 06.12.2019, operatori ekonomik “International Security Albania” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ku ka ngritur pretendime për pikën 1 (sallën operative) dhe pikën 2 (saktësimin e numrit të rojeve), si dhe ka hequr pretendimin e tretë

(mbi të dhënat e kërkuara për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në vërtetimin e performancës), duke shtuar gjithashtu se:

*“Me date 03.12.2019 AK "Drejtoria Spitalit Rajonal Diber" ben nje shtojce ne sistem ne SPE por tek specifikimet teknike nuk ka saktesuar me sa roje duhet te kryhet sherbimi ne vendrojet perkatese 24-ore sherbim, si dhe periudhen e sherbimit, pasi ne specifikime teknike eshte percaktuar eshte vendosur periudha me afat 04 muaj kur ne objektin e procedures eshte vendosur periudha 12-muaj!!!.*

*Duhet te specifikoni sakte numrin e rojeve per vendroje ne kete shtojce si dhe periudhen e sakte te sherbimit per vendroje me sherbim 24-ore qe te mos krijohet konfuzion ne pergatitjen e oferte ekonomike”.*

II.5. Në datën 26.12.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. prot.1856/2, shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1236/1 prot, datë 18.12.2019, bashkëngjitur informacioni dhe dokumentacioni mbi hartimin e dokumentave të tenderit dhe trajtimin e ankesës.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “International Security Albania” shpk, për modifikimin e kriterit “Salle operative ne pronesi ose me qera me vendndodhje ne qytetin e Peshkopise. Autoriteti Kontraktor ne kundersizim me legjislacionin ne fuqi perkatesisht Ligjin 75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", kerkon Akt Miratim te miratuar nga DVP Diber me seli Bashkia Peshkopi. Sqarojme A.K se Bashkia Peshkopi eshte nen juridiksionin e DVP Diber dhe kur nje operator Qendren e Kontrollit e ka ne ne nje zone administrative te Qarkut Diber, akti i miratimit eshte i vlefshem per te gjithe qarkun Diber njekoheisht edhe per qytetin Peshkopi i cili ben pjese ne qarkun e Dibres dhe DVP Dibres eshte ajo qe ka juridiksionin e ketij qarku. Te kerkosh qender kontrolli ne rastin konkret ne njesine administrative Peshkopi nuk eshte ne gjykimin tone kriter ligjor por eshte thjesht nje tentative per te kufizuar pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne kete procedure kjo se paku eshte mese evidente. Sic eshte dhe evidente kerkesat absurde te certifikatave te pronesise apo kontratave te qirase, perderisa DVP Diber si organi certifikues i salles se kontrollit pajis Operatorin me Akt-Miratimin e salles se kontrollit, dokumentacioni tjetër qe ju kerkoni eshte i panevojshem. Per sa

*me lart i kerkojme A.K te ndryshoje kriterin e sipercituar duke hequr shprehjen me vendodhje ne qytetin Peshkopi por duke e lene qe salla operative te jete Brenda QARKU Diber”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në dokumentet e modifikuar të tenderit, shtojca 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, seksioni “Kapaciteti teknik”, pika 12, është parashikuar si vijon:

*“Salle operative ne pronesi ose me qera me vendndodhje ne qytetin e Peshkopise”.*

III.1.2. Neni 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [....]*”.

III.1.3. Në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 22 “Qendra e kontrollit të SHPSF-së”, pika 1 është përcaktuar: “*Subjekti i licencuar për aktivitetin e shërbimit privat të sigurisë fizike, në çdo njësi administrative që ushtron veprimtari, duhet të ketë qendër kontrolli, ku të tregohet adresa e saj fizike dhe elektronike, si dhe stema me emërtimin e shoqërisë”.*

III.1.4. Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, makineri dhe pajisje të nevojshme dhe të mjaftueshme, për realizimin e kontratës me sukses në afat dhe në cilësi sipas përcaktimeve të dokumentave standarte të tenderit.

III.1. Nga kuptimi literal i pikës 1 të nenit 22 të ligjit nr. 75/2014 datë 10.07.2014, do të thotë se shoqëria e shërbimit privat të sigurisë fizike duhet të disponojë në një nga format ligjore qendër kontrolli në çdo njësi administrative që ushtron veprimtari. Duke qenë se, qendra e menaxhimit dhe kontrollit është ambienti me mjete/pajisje që shërben për menaxhimin, kontrollin e veprimtarisë private të sigurisë fizike si dhe referuar faktit se zotërimi i saj verifikohet nga Drejtoria e Policisë së Qarkut përkatës dhe pasqyrohet në vërtetimet përkatëse të lëshuara nga ky institucion i cili monitoron edhe veprimtarinë e SHPSF-ve në njësitë administrative përkatëse ku ato ushtrojnë aktivitetin e tyre, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kërkesa e përcaktuar

nga autoriteti kontraktor se qendra e kontrollit duhet të jetë *“Salle operative ne pronesi ose me qera me vendndodhje ne qytetin e Peshkopise”*, është e ekzagjeruar, diskriminuese si dhe kufizon konkurrencën, duke lejuar vetëm një numër të kufizuar shoqërisht të jenë pjesëmarrëse, në kundërshtim me nenet 1, 2, 46/3, të LPP-së dhe rregullat e prokurimit publik. Në mënyrë që të stimulohet gjithëpërfshirja dhe konkurrenca mbështetur edhe në nenin 1, pika 2 “c” dhe “ç” e ligjit të Prokurimit Publik, kriteri i sipërcituar do të konsiderohej i përmbushur duke vërtetuar zotërimin e Qendrës së Kontrollit në qarkun Dibër si dhe dokumentacionin shoqëruar për disponimin e saj, në një nga format ligjore të kërkuara.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues *“International Security Albania”* sh.p.k qëndron.

III.1.6. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se disponimi i pronësisë/qirasë lidhet ngushtë me krijimin e bindjes së autoritetit kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë kapacitete lidhur me qendrën e kontrollit. Në anën tjetër disponimi i kapaciteteve lidhur me qendrën e kontrollit mund të vërtetohet më së miri edhe me anë të dokumentacionit përkatës sikundër është vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut apo akoma më tej Akt Miratimi i Qendrës së Kontrollit, dokumenta të cilat krijojnë tërësisht bindjen e autoritetit për plotësimin e këtij kriteri. Në sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues *“International Security Albania”* sh.p.k qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit *“International Security Albania”* sh.p.k se *“Duhet te specifikoni sakte numrin e rojeve per vendroje ne kete shtojce”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se referuar informacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton se autoriteti kontraktor e ka trajtuar pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues duke sqaruar se numri i rojeve për një vendroje me tre turne është 4,98 roje, por nuk e ka pasqyruar këtë sqarim në shtojcën e publikuar.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, në lidhje me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues gjykon se, duke qenë se ky pretendim është sqaruar nga autoriteti kontraktor, nuk do të merret në shqyrtim në themel, pasi nuk ekziston më si objekt ankimi. Sa më sipër, autoriteti kontraktor në zbatimin e këtij vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik krahas konstatimeve të vendimarrjes së K.P.P. duhet të pasqyrojë njëherazi edhe sqarimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej autoritetit kontraktor, duke publikuar në SPE sqarimin e mësipërm (shoqëruar gjithashtu me saktësimin e të gjithë elementëve të domosdoshën për pëllogaritjen e kostos, siç është afati i kryerjes së shërbimit etj), në bazë të nenit 42, pika 2 të LPP, që përcakton se:

*“2. Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një*

*operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike”.*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “International Security Albania” sh.p.k se *“Duhet te specifikoni periudhen e sakte te sherbimit per vendroje me sherbim 24-ore qe te mos krijohet konfuzion ne pergatitjen e oferte ekonomike”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Duke mbajtur në konsideratë faktin që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë pretendimi i ngritur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ky i fundit nuk është ankuar lidhur me pretendimin e mësipërm pranë autoritetit kontraktor.

III.3.2. Në nenin 63, pika 1, 1.1 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.* Për sa kohë që pala ankimuese nuk ka shteruar pretendimin e mësipërm në shkallën e parë të ankimit, parashikuar nga lex specialis brenda afatit 7 ditor nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, ankimuesi nuk legjitimohet ta paraqesë këtë pretendim në organin më të lartë ( KPP), për shkak të mosrespektimit të shkallëve të ankimit.



Sa më sipër pretendim i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues nuk do të merret në shqyrtim.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “International Security Albania” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-43724-11-18-2019, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të godinave dhe ambienteve rrethuese të Spitalit Rajonal Diber”- Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, tre vend roje me tre turne (T1+T2+T3)”, me fond limit 9.487.854 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 20.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “International Security Albania” shpk.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1856Protokolli, Datë 06.12.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**